REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 986 Prot. Tiranë, më 03.06.2025

**VENDIM**

**Nr. 5, DATË 03/06/2025**

**MBI**

**"MIRATIMIN E ANALIZËS PËR VEPRIMTARINË EKONOMIKE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2025"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 3 *(Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë)*, neni 49 *(Funksionet e Bordit të Administrimit)*, të Statutit të UART dhe sipas materialit bashkëlidhur të Administratores së UART, pas shqyrtmit dhe diskutimeve, Bordi i Administrimit të UART,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e analizës për veprimtarinë ekonomike të Universitetit të Arteve për periudhën Janar – Prill 2025 (sipas materialit bashkëlidhur).

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Lavdrim SAHITAJ** **Prof. Besnik Bisha**

**(Kryetar)** **(Anëtar)**

Jeton SHEHU

______________
(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

______________
(Anëtar)

Ergis SEFA

______________
(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

______________
(Anëtar)

Vladimir Llakaj

______________
(Anëtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 940/1 Prot. Tiranë, më 27.05.2025

**Lënda:** Përcillen vendimet e Senatit Akademik të mbledhjes së datës 26 Maj 2025

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UART**

**Për dijeni:** **ADMINISTRATORIT TË UART,**
**Znj. Alma Sinanaj**

*Të nderuar,*

Nëpërmjet kësaj shkrese, përcillet, për procedura të mëtejshme, VSA nr. 30, datë 26.05.2025 "Për miratimin paraprak të propozimit për shpërndarjen e të ardhurave të institucionit dhe shtesën e regjistrit të prokurimeve për vitin kalendarik 2025, në Universitetin e Arteve" si dhe VSA nr. 31, datë 26.05.2025 "Për miratimin paraprak të analizës për veprimtarinë ekonomike të Universitetit të Arteve për periudhën Janar – Prill 2025".

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**REKTORI**

**Prof. Dr. Erald Bakalli**

**Në mungesë dhe me porosi:**

**ZËVENDËSREKTORI**

**Prof. Asoc. Dorian Çene**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 940 Prot. Tiranë, më 26.05.2025

**VENDIM**

**Nr. 30, datë 26.05.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN PARAPRAK TË PROPOZIMIT PËR SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE TË INSTITUCIONIT DHE SHTESËN E REGJISTRIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN KALENDARIK 2025, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 38, 108 dhe 109 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin elektronik", të germës "c", të pikës 3, të nenit 6 të Statutit të Universitetit të Arteve dhe pas shqyrtimit e diskutimit të relacionit nr. 920 prot., datë 23.05.2025 të Administratorit të Universitetitit të Arteve, Senati Akademik i UART,

**VENDOSI:**

1. Miratimin paraprak të propozimit për shpërndarjen e të ardhurave në Universitetin e Arteve për vitin kalendarik 2025, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin paraprak të shtesës së regjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2025, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim t'i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

| | |
|---|---|
| Prof. Dr. Erald Bakalli | Prof. Najada Hamza |
| Prof. Arben Llozi | Prof. Miltiadh Kutali |
| Prof. Sadik Spahija | Prof. Lorenc Radovani |
| Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha) | Prof. Endri Sina |
| Prof. Rudina Ciko | Prof. Gazmend Gjoka |
| Prof. Asoc. Dorian Çene | Prof. Asoc. Albes Fusha |
| Prof. Asoc. Edmond Gjikopulli | Prof. Asoc. Kristina Laço |
| Prof. Asoc. Genci Fuga | Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj |
| Prof. Asoc. Orion Shima | Enea Trimi (Student FAB) |
| Rei Kita (Student FM) | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR

Nr. 920 prot. Tiranë, më 23/05/2025

Propozim për shpërndarjen e të ardhurave dhe rregjistrin e prokurimit për vitin 2025

Senatit Akademik të Universitetit të Arteve

Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve

Universiteti i Arteve, për vitin 2025, ka parashikuar të realizojë të ardhurat me vlerë 38.949.404 lek. Burimet e krijimit të të ardhurave, për vitin 2025, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

| Nr. | Burimet e krijimit | Vlera (lek) |
|---|---|---|
| 1 | Tarifë shkollimi | 26,488,700 |
| 2 | Tarifë konkurrimi & rregjistrimi | 2,537,100 |
| 3 | Shërbim salle | 6,000,000 |
| 4 | Qira ambjente | 2,364,804 |
| 5 | Diploma,vërtet., shtypshk etj | 300,000 |
| 6 | Tarifë për marrje titulli | 758,800 |
| 7 | Tarifë pjemarrje në KNAE | 500,000 |
| | Te ardhura UART | 38,949,404 |

Në vijim do të paraqesim shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

- Zëri "Tarifë shkollimi" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga tarifat e shkollimit përcaktuar në vendimet përkatëse (*VBA Nr.9 datë 29/02/2024 dhe VSA Nr.13 date 07/02/2024*) për këtë qëllim. Parashikimi i këtyre të ardhura është bazuar në numrin e studentëve, të cilët janë rregjistruar dhe do të paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, gjithsej 557 studentë.
  Nga këto:
  245 studentë të rregjistruar në Ciklin e Parë, vlera e parashikuar të arkëtohet do të jetë 7.535.000 lekë
  312 studentë në ciklin e dytë. Vlera e parashikuar të arkëtohet do të jetë 18.953.700 lekë.
- Zëri "Tarifë konkurrimi & rregjistrimi" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat, që sipas vendimeve të organeve drejtuese të UART (*VBA Nr.9 datë 29/02/2024 dhe VSA Nr.13 date 07/02/2024*), për këtë qëllim, parashikohen të realizohen nga konkurset e pranimit dhe tarifat e rregjistrimit, te cilët realizohen për aplikantët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në UART.
- Zëri "Shërbim salle" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga kontratat e shërbimit me subjektet private dhe shtetërore, bazuar në tarifat e shërbimit të miratuar me VBA Nr.26 datë 07.11.2024.
- Zëri "Qira ambjente" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga dhënia me qira e ambjenteve të UART. Në planifikimin e këtij zëri jemi bazuar në tre kontrata, subjekt i të cilave është dhënia me qira e ambjenteve të UART.

- Zëri "Diploma,vërtetime, shtypshkrime etj" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga tarifat që aplikohen për marrjen e diplomave, nga ana e studentëve , vërtetimet e ndryshme. Parashikimi është bazuar në realizimin e vitit 2024.
- Zëri "Tarifë për marrje titulli" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat, që sipas vendimeve të organeve drejtuese të UART (*VBA Nr.15 datë 10/07/2024 dhe VSA Nr.92 date 09/07/2024*), për këtë qëllim, parashikohen të realizohen nga tarifat për marrjen e titujve "Profesor" dhe "Profesor i asocuar" në Universitetin e Arteve.
- Zëri "Tarifë pjemarrje në KNAE" – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat, që parashikohen të realizohen nga tarifat për pjesmarrjen në Konferencën e I-rë Ndërkombëtare mbi Artet dhe Edukukim (KNAE), e cila do  të organizohet nga Universiteti i Arteve. Tarifa e pjesmarrjes është propozuar të jetë 5.000 (pesëmijë) lek dhe parashikohet të ketë 100 pjesmarrës.

Në grafikun e mëposhtëm, është paraqitur pesha specifike që zë cdo burim në krijimin e të ardhurave, në raport me të ardhurat totale, që parashikohen të realizohen për vitin 2025.




Në tabelën e mëposhtme janë paraqituar të ardhurat e realizuara në vitin 2022,2023 dhe 2024, krahasuar me ato të parashikuara të realizohen për vitin 2025.

| Nr. | Burimi i krijimit i te ardhurave | Viti 2022 Realizim (Lek) | Viti 2023 Realizim (Lek) | Viti 2024 Realizim (Lek) | Viti 2025 Parashikim (Lek) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tarifë shkollimi | 33,221,810 | 30,419,349 | 41,237,977 | 26,488,700 |
| 2 | Tarifë Shkollimi (doktoraturë) | - | 1,259,000 | 1,386,000 | - |
| 3 | Tarifë konkurrimi & rregjistrimi | 2,256,730 | 2,597,430 | 1,916,120 | 2,537,100 |
| 4 | Shërbim salle | 555,000 | 1,060,000 | 3,235,000 | 6,000,000 |
| 5 | Qira ambjente | 2,859,658 | 2,364,804 | 2,197,677 | 2,364,804 |
| 6 | Diploma,vërtet., shtypshk etj | 457,833 | 457,405 | 235,900 | 300,000 |
| 7 | Tarifë për marrje titulli | - | - | 1,294,800 | 758,800 |
| 8 | Tarifë pjemarrje ne KNAE | - | - | - | 500,000 |
| | TOTALI | 39,351,031 | 38,157,988 | 51,503,474 | 38,949,404 |

Referuar sa më sipër, propozojmë, që të ardhurat e parashikuara të realizohen për vitin 2025 me vlerë 38,949,404 lek dhe ato të trashëguara nga viti 2024, me vlerë 8.625.448 lek, të shpërndahen si në tabelën e mëposhtme.

| Nr. llog. | Emërtimi | Shpenzime (lek) |
|---|---|---|
| 600 | Paga | 31,353,923 |
| 601 | Sigurime shoqërore dhe shëndetsore | 4,617,305 |
| 602 | Mallra dhe shërbime | 11,000,224 |
| 606 | Rimbursim tarife për studentë | 260,000 |
| 231 | Investime | 343,400 |
| | TOTALI | 47,574,852 |

Në vijim paraqiten shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

1. **Paga** – në këtë zë janë përfshirë:

    - Shpenzimet për paga për punonjësit me kohë të pjesshme (*personeli akademik i ftuar 9.668 orë*) për vitin akademik 2024-2025, si dhe punonjësit me kontratë.
    - Shpenzime për paga për personelin me kohë te plotë, akademik dhe administrative, per vitin 2025, me vlerë *16.248.996* lek, mbasi granti i ardhur nga MAS dhe miratuar për vitin 2025, nuk mbulonte plotësisht fondin për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
    - Shpenzime për pagesën pjesore të mbingarkesës se personelit akademik në vlerën 4.324.559 *lek*. Vlera e plotë e shpenzimeve per pagesën e mbingarkesës se personelit akademik është 31.116.330 lek.

2. **Sigurime shoqërore dhe shëndetësore** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që rrjedhin nga shpenzimet e parashikuara në zërin paga.

3. **Mallra dhe shërbime** – në këtë zë janë përfshirë:

    - Shpenzime për "Energji elektrike dhe "Ujë" ne vleren 3.500.000 lek. Rritja e këtyre zërave vjen si pasojë e vënies në perdorim të plotë të Sallës së Madhe të Koncerteve mbas rikonstruksionit.
    - Tarifa për vitin 2025, me vlerë 1.200.000 lek, ndaj Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik (QNRA), bazuar ne kontratën Nr.1871 prot. Date 16.12.2023, objekt i të cilës është ofrimi nga QNRA i shërbimeve informatike dhe internetit për UART.
    - Pagesat e antarëve të jurive, kryetarit, antarëve dhe sekretariatit për Komisionin e Promovimin të Përsonelit Akademik (KPPA), bazuar në VBA Nr.15 datë 14.07.2024, me vlerë 2.828.124 lek.
    - Taksa bashkiake me vlerë 68.500 lek.
    - Shpenzimet për pagesën e udhëheqësve të temës së disertacionit të studentëve të Ciklit të Tretë (Doktoraturë), për vitet 2023-2024, me vlerë 2.096.600 lekë.
    - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të lëshojë urdhër ekzekutimi, për vendimin gjyqësor të çështjes me Nr 14379/3615 Regj.Them., Nr 1647/U Vendimi,

datë 23.02.2025, në të cilin parashikohet që Universiteti i Arteve të paguajë shumën 1.107.000 lek në favor të ish punonjësit të UART, z.Vladimir Dhamo

- Pagesa ndaj znj. Majlinda Hala, e cila është pedagoge pranë Universitetit të Arteve, në vlerën 30.000 lek. Universiteti i Arteve ka arketuar nga Universiteti i Tiranes, Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS), në Dhjetor 2024, vlerën prej 30.000 lek, për angazhimin që znj. Majlinda Hala ka patur në trajnimet pranë kursit të Psiko-Pedagogjisë ne FSHS. (*shkresa Nr.2237/2 prot. datë 23.12.2024 e FSHS*)
- Printime, baner dhe të ngjashme, me vlerë 170.000 lek, për zhvillimin e Konferencës se I-rë Ndërkombëtare mbi Artet dhe Edukukim (KNAE), cıla do të zhvillohet në Qershor 2025, në Universitetit e Arteve.

4. **Rimbursim tarife për studentë** – në këtë zë është parashikuar rimbursimi i tarifës së shkollimit për 12 studente. Rimbursimi vjen si pasoje se studentet kanë paguar me shume ose se mbasi kane realizuar pagesën, bazuar ne VBA, kanë përfituar reduktim ose perjashtim nga tarifa e shkollimit.

5. **Investime** – në këtë zë është parashikuar blerje libra per bibliotekën shkencore te UART.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur pesha specifike, që zë çdo shpenzim në raport me shpenzimet totale, të cilat parashikohen të realizohen për vitin 2024, me burim financimi të ardhurat e UART.




Alma [illegible]

ADMINISTRATOR

**Tabela Nr.1**
Shpërndarja e të ardhura të UA për vitin 2025

| Nr. llog. | Emertimi | Vlera (lek) |
|---|---|---|
| 600 | Paga | 31,353,923 |
| 601 | Sigurime shoqërore dhe shëndetsore | 4,617,305 |
| 602 | Mallra dhe shërbime | 11,000,224 |
| 606 | Rimbursim tarife për studentë | 260,000 |
| 231 | Investime | 343,400 |
| | TOTALI | 47,574,852 |

**Tabela Nr.2**
Rregjistri i prokurimeve, me burim financimi të ardhurat e UA, për vitin 2025.

| Nr. llog. | Emërtimi | Kap.6 (lek) |
|---|---|---|
| 602 | Shërbime të printimit dhe publikimit | 170,000 |
| 231 | Blerje libra | 343,400 |
| | TOTALI | 513,400 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 921/1 Prot. Tiranë, më 26.05.2025

**VENDIM**

**Nr. 31, datë 26.05.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN PARAPRAK TË ANALIZËS PËR VEPRIMTARINË EKONOMIKE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2025**

Në mbështetje të nenit 3 dhe 38 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të Statutit të Universitetit të Arteve dhe pas shqyrtimit e diskutimit të relacionit nr. 921 prot., datë 23.05.2025 të Administratorit të Universitetitit të Arteve, Senati Akademik i UART,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë paraprakisht analizën për veprimtarinë ekonomike të Universitetit të Arteve për periudhën Janar – Prill 2025 (sipas materialit bashkëlidhur).

2. Ky vendim t'i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Dr. Erald Bakalli** **Prof. Najada Hamza**

**Prof. Arben Llozi** **Prof. Miltiadh Kutali**

**Prof. Sadik Spahija** **Prof. Lorene Radovani**

Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina

Prof. Rudina Ciko

Prof. Gazmend Gjoka

Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha

Prof. Asoc. Edmond Gjikopulli

Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)